



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL
DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Tiranë, më 15.02.2021

NJOFTIM PUNËSIMI

Bazuar në në Vendimin nr.1151, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2021, në njësitë e qeverisjes qendrore”, AZHBR shpall njoftimin e punësimit për vendet e pa plotësuara si mëposhtë vijon :

I. SEKTORI I IT:

SPECIALIST (me kontratë pune të përkohshme 6h/ditë), kategoria IV-b

Detyrat kryesore:

1. Ofron suport për rrjetin kompjuterik dhe pajisjet në rastet kur ka nevojë në institucion.
2. Asiston në mbledhjen e kërkesave për teknologjinë e informacionit.
3. Siguron edukimin e përdoruesve mbi funksionet e sistemeve dhe se si të përdorin me efektivitet pajisjet dhe programet për kryerjen e detyrave të ngarkuara.

Kandidatët e interesuar duhet të përmbushin këto kriterë:

1. Diplomë e nivelit “Master Profesional”, në Shkenca Kompjuterike, Inxhinieri elektronike, Informatikë, Teknologji informacioni, Inxhinieri telekomunikacioni.
2. Të kenë aftësi shumë të mira komunikuese.
3. Të kenë njohuri bazë në përdorimin e kompjuterit
4. Të kenë njohuri bazë mbi zhvillimin bujqësor dhe rural në Shqipëri dhe mbi politikën e përbashkët për bujqësinë me BE-në. Të kenë njohuri të gjuhës angleze.
5. Preferohet të kenë përvojë pune ose internshipi/praktika profesionale.

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- Njohuri mbi ligjin nr. 10 325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”.
- Njohuri mbi ligjin nr. 10 273, datë 29.4.2010 “Për dokumentin elektronik”.
- Njohuri mbi ligjin nr. 107/2018 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.
- Njohuri mbi VKM nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë brenda datës **18.02.2021, ora 16.30** në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Adresa: Rruga “Muhamet Gjollesha”, Nr. 56, Tiranë): Kërkesën për punësim ku duhet të përcaktojnë pozicionin për të cilin po aplikojnë; një kopje të CV të përditësuar; diplomën e noterizuar; certifikata dhe kualifikime të ndryshme; një fotokopje e librezës së punës; një kopje të ID-së; formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore të firmosur nga aplikuesi; raportin mjeko-ligjor.

TË GJITHË KANDIDATËT QË APLIKOJNË PËR POZICIONET E MËSIPËRME, DO TË MARRIN INFORMACION VETËM NË FAQEN E INTERNETIT TË AZHBR www.azhbr.gov.al, PËR FAZAT E MËTEJSHME TË KËSAJ PROCEDURE:

- për rezultatet e verifikimit
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi (testim me shkrim/ intervista me gojë)
- shpalljen e listës së fituesve

Për të marrë këto informacione, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e internetit të AZHBR www.azhbr.gov.al.

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL